



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 17255Prot

Lezhë, më 25 . 10 .2024

VENDIM

Nr. 424 , Datë 25 . 10 .2024

"PER

DELEGIM FUNKSIONESH TEK ADMINISTRATORËT E NJËSIVE
ADMINISTRATIVE"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Kreut II të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative I Republikës së Shqipërisë", Ligji nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Ligji nr.9270 date 29.07.2004, "Për Sistemin e Adresave" i ndryshuar, Ligji Nr. 10 129, date 11.05.2009 "Per gjendjen civile":

VENDOSA:

- I. Delegimin e kompetences në fushën e saktësimit të adresave të Administratorët e Njësive Administrative për kryerjen e veprimeve të përcaktuara nga neni 3; neni 4; neni 4/1, i Ligjit nr. 9270 datë 29.07.2004, "Për sistemin e adresave", i ndryshuar, konkretisht për kryerjen e veprimeve në zonat rurale si më poshtë:

Emërtimi i bulevardëve, rrugëve, rrugicave, shesheve dhe parqeve bëhet me vendim të këshillit të njësive të vetëqeverisjes vendore, nën juridiksionin e të cilave ato ndodhen, ndërsa numërtimi i ndërtesave, hyrjeve dhe apartamenteve bëhet nga seksionet/zyrat e urbanistikës në bashkitë/njësitë administrative, nën juridiksionin e të cilave ato ndodhen.

Sistemi i adresave zbatohet për çdo lloj ndërtese, pavarësisht nga destinacioni i saj, për banim ose jo (hotel, zyrë, qendër tregtare ose komunikacioni, ndërtesë industriale, arsim, muzeum, spital etj.), si dhe pavarësisht nga vendndodhja në territorin e Republikës së Shqipërisë. 1. Çdo njësi e qeverisjes vendore krijon, përditëson dhe administron të dhënat në regjistrin vendor të adresave. 2. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile krijon dhe administron Regjistrin Kombëtar të Adresave. 3. Mënyra e krijimit, administrimit të regjistrave vendorë dhe Regjistrin Kombëtar të Adresave, si dhe rregullat e shfrytëzimit të sistemit e të rrjetit informatik përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Administrata e njësisë së administrimit vendor, pasi verteton pronesine mbi pasurine ne te cilen kerkohet saktësimi I adresave, jep saktësimin e adreses qytetarit.

III. Administratorët sipas përcaktimeve të mësipërme kanë kompetencë të plotë në shyrqtimin, administrimin dhe regjistrimin e ndërtesave te paregjistruara, si dhe të drejtën të firmosë saktësimet e adresave të banorëve të njësisë administrative.

IV. Çdo miratim për ndërhyrjet që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi nga administratorët duhet të njoftohet Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, në Bashkinë Lezhë, për monitorimin e zbatueshmërisë së ndërhyrjeve të miratuara.

V. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Administratorët e Njësive Administrative të Bashkisë Lezhë dhe Gjendja Civile.

VII. Ky Vendim hyn në fuqi me njoftimin e tij

KRYETARI

Pjerin Ndren



Drejtoria D.P.T.ZHU
Miratoi; Flamur Kuçi
Koncept; Jurgen Marku
Kopje nr. 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

NJËSIA ADMINISTRATIVE _____

SAKTESIM ADRESE TE BANESES NGA ADRESARI

NE PRONE: _____

(Dokumenti mbi te cilin eshte referuar saktesimi adreses)

KERKUES: _____

Rruga: _____

Ndertesa nr.: _____

Hyrja nr.: _____

Apartament nr.: _____

Fshati/Qyteti: _____

Njësia Administrative: _____

Kodi postar: _____

(Pozicioni i Nepunesit) _____

(Emri I Nepunesit) _____

(Firma E nepunesit) _____